# DËSHMI ARKIVI

**A-434270**

VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Banorët e Marinzës sërish protestë kundër "Bankers Petroleum": Ose të na paguajnë qiranë e tokës, ose të largohet kompania – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/banoret-e-marinzes-serish-proteste-kunder-bankers-petroleum-ose-te-na-paguajne-qirane-e-tokes-ose-te-largohet-kompania/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 07:18:55 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 07:15:26 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `530c6747b543a7c353f20ad4167a71f0a239704bcad7f149a4e347a1f9eda41e` |
| TEKSTI | `6d5bd1bde9c1d478d488fd5438bd77de0c92858c3efc88005fe071651d0818b3` |
| PAMJA | `48987e88f21483dc9360ff4de9d852b5675d65e2c18aff27825617fde4fd4125` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c7eccc730b3176a69843feb14b91fb0278fc07703e953800d6d1d93a0002fea8` |
| E MËPARSHMJA | `2c34b8a186a4831fac94dbc682859f71da874c89d29830b6180d6e1b67f63fd7` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c7eccc730b3176a69843feb14b91fb0278fc07703e953800d6d1d93a0002fea8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Protesta e banorëve të fshatrave të zonës naftëmbajtëse të Marinzës është zhvendosur këtë mëngjes përpara sheshit satelit 3 të kompanisë Bankers Petroleum. Pas protestës së dy ditëve më parë pranë zyrave në vendburim, ku nuk pati asnjë negociatë me përfaqësuesit e kompanisë, banorët kanë vendosur të përshkallëzojnë protestën duke bllokuar aktivitetin në sheshet naftënxjerrëse.

Siç kishin paralajmëruar, protestuesit janë mbledhur sot para sheshit satelit 3 dhe kanë hyrë me forcë brenda ambienteve të tij, në përpjekje për të ndaluar punën. Ata kundërshtojnë përgjysmimin e vlerës së qirasë së tokës, nga 4 milionë lekë për dynym në 2 milionë lekë.

Banorët thonë se prej dy vitesh kërkesat e tyre nuk janë marrë parasysh dhe paralajmërojnë se protesta do të vijojë deri në gjetjen e një zgjidhjeje.

*"Do bëjmë ç'është e mundur, kemi dy vjet që po na tallin. Naftë ka shumë, ai thotë 'jam me humbje'. Ti vetë erdhe në tokën time, tani thonë 'nuk më del hesap'. Unë me atë tokë ushqehem", u shpreh një prej banorëve.*

Një tjetër protestues kërkon që, nëse kompania nuk pranon të paguajë qiranë, toka t'u kthehet pronarëve në gjendjen e mëparshme.

*"Kërkojmë që të na hapet porta, punonjësit që janë brenda të dalin jashtë. Sot e tutje do kalojë gjithsecili te pronat e veta. Mos të mendojnë se do vijmë një orë e do ikim. Jemi të vendosur t'i shkojmë deri në fund. Ose të na paguajë, ose të largohet kompania", deklaroi një tjetër banor.*

*"Këtu kam 1 hektar tokë. Ai ose të paguajë...ai ka dhe gurin dhe arrën. Ne*

5 Beqaj uron hisjen e vitit të ri shkollor! Besoni te vetja dhe tek ëndrrat,...

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

*s'kemi…shteti nuk është shtet", thotë një banor tjetër.*

Protestuesit shprehen të vendosur të vijojnë bllokimin e aktivitetit, ndërsa kërkojnë ndërhyrjen e institucioneve shtetërore për zgjidhjen e konfliktit mbi vlerën e qirasë së tokave.

#marinze #proteste

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI

**"Smart City", Kumbaro: Kamerat…**

Xhuljana Zhuleku · 34 minuta më parë



VENDI

**Nis shkolla, Kumbaro prezanton risitë në…**

Xhuljana Zhuleku · 46 minuta më parë



VENDI

**Nis sezoni i ri shkollor, 680 nxënës më pak…**

Xhuljana Zhuleku · 2 orë më parë

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.